




Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klllokot-Vrbovc/Opština Klokot-Vrbovac

Vendi takimeve	I	Lokaliteti I Kuvendit Komunal Klllokot
Data: 31.01.2019		

Në bazë të nenit 43.pika (43.1,43.2,43.3,43.4,43.5)Ligjit për qeverisje Lokale nr 03/L-040,si dhe statutit Komunal sipas nenit 18.Është mbajtur séance e parë e Kuvendit Komunal në Komunën e Klllokot –Vërbovcit për vitin 2019 , me rendin e ditës të përcaktuar më herët . Me atë rast është bërë si në vijim

PROCESVERBAL NGA SEANCA E PARË E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL KLLOKOT-VËRBOVC PËR VITIN 2019

Seancën e udhëheqi kryesuesi I Kuvendit Komunal Klllokot –Vërbovc z.Zarko Dejanovic .

Në fillim kryesuesi I përshëndeti të gjithë të pranishmit , delegatët , qytetarët , drejtorët , përfaqsesit e OSBE-së nënkryetarin , përfaqsesit e bashkimit Evropjan dhe Kryetarin e Komunës .

Pasi I ftoj delegatët është konstatuar kuorumi për punën e seancës .

Antarë present 15

- 1. Miratimi I procesverbalit nga séance e dymbëdhjetë e rregullt e Kuvendit Komunal nga viti 2018 .**
- 2. Propozim –Vendim për miratimin e vneimit për dhënjën e pelqimit për ndërtimin e shkollës në parcellën me numër 7370102600957-5 zona katastrale Klllokot për nxënsit nga klasa 0-9 ;**
- 3. Formimi I grupës punuese për përpilimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2019**
- 4. Propozim –Vëendim për reralizimin e procedurës ligjore dhe miratimin e vendimit të Kuvendit – Komunal për emrimin e zëvendskryetarit për komunitete .**

Kryesuesi para së gjithave pyeti a e dëshiron dikush fjalën për plotësim ose ndryshim të rendit të ditës . Për fjalë u paraqit Kryetari I komunës , I cili së pari I përshëndeti të gjithë të paranishmit dhe dëshiroj të tërhek pikën e dytë të rendit të ditës dhe ka plotësisht të drejt sepse duhet të mblidhet materiali I nevojshëm I dokumenteve .

Kryesuesi tha se Kryetari ka të drejtë të propozoj dhe të tërheq pikat nga rendi I ditës , kështu që pika e dytë është tërhequr nga rendi I ditës , pastaj pyeti se a dëshiron edhe dikush të thotë diçka .

Për fjalë u paraqit z.Hidajet Ahmeti I cili I përshëndeti të gjithë pastaj e propozoj pikën për rend dite .Diskutimi për presion të vazhdueshmëm të puntorëve në baza etnike .

Pastaj për fjalë u paraqit nënkryetari I komunës z.Sasa Mirkovic I cili tha se e kupton Hidajeti në një prononcim , konsideroj se është jo I drejtë nga ana e tijë , në komunë duhet të punohet të mbahet rregulli dhe diciplina nëse janë mësuar që në mandatin e kaluar të shetisin gjatë orarit të punës .

Qytetari nuk guxon të pres për cilin do document në komunë . Përgjithsi mbajnë të gjithë puntorët qoft Shqiptar apo serb , dëshiroj të them edhe të propztoj kryesuesit se a po bëhet presion në ndonjë Shqiptar apo serbi , konsideroj se mund të bisedojm në pikën të ndryshme për të mos humbur kohë.

Kryesuesi I Kuvendit tha se nuk pajtohet me zëcvendësin e tijë , dhe prej nga këto akuza kur aji nuk ka qen asnjë ditë në punë edhe pse është I obliguarë dhe nga e din se po behetë dikriminim në puntorë . z.Hidajet tha se deklarata direkte e kryesuesit dhe nënkryetarit është një presion direct në seancë sepse nuk mund të më kufizoj . Sa I përket punës unë I kam bërë shkresë me shkrim që të më sigurohet zyrja në menyrë që të mund të punoj , por nuk kamë marë asnjë përgjigje .Nuk mund të më kufizoj as kryetari as nënkryetari , kjo është e drejtë e imja . Deklarata kjo është një kamoflim nga ana e nënkryetarit . z. Mirkovic ju përgjigj se z.Hidajet me rrugët ligjore duhet të jetë në vendin e punës ku do që ka dhe most ë flasim për disa polemika . kryesuesi filloj me pikën e parë të rendit të ditës .

1 . Miratimi I procesverbalit nga séance e dymbëdhjetë e rregullt e Kuvendit Komunal nga viti 2018 .

Kryesuesi pyeti a dëshiron dikush të thot diçka për procesverbalin ?

Për fjalë u paraqit z.Hidajet Ahmeti I cili propozoj që procesverbalet të shkruhen sin ë komunat tjera dhe në to të shkruhet se kushnga delegatët ka qen pro ose kundër nd onjë vendimi me emër dhe mbiemër , sepse këta arhivohen në arhivën komunale dhe duhet të dihen emrat , për më vonë .Pastaj fjalën e mori z.Shqiprim Rexhepi , aji I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe shtoj se pajtohet me rekomandimet e Hidajetit dhe e ceku se propozon që secila seancë të ingjizohet dhe delegatët ta

shohin , të jetë video ingjizim , në mënyrë që ta marrin dhe ta kenë delegatët , kryesuesi ju përgjigj se kjo vetëm se po ingjizohet , dhe e dha në votim pikën e parë

Kryesuesi e konstatoi se pika parë është miratuar me shumicë të votave 10 për , 5 delagat nuk u deklaruan .

Pastaj kryesuesi kaloj në pikën e dytë të rendit të ditës .

2. Formimi I grupës punuese për përpilimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2019 ;

Kryesuesi tha se rreth përpilimit të planit të punës për kuvend duhet të marrin pjesë 3 antar nga egzekutivi dhe 2 antar nga legjistativi ose e kundërta gjithsejt 5 antar . Unë si kryesues duhet të jemë obligativisht antar gjithashtu propozoj drejtoreshën e administratës , kënd do ta propozoni ju

Delegatët I propozuan 5 antarët , kryesuesi I dha në votim .

Me 13 vota për u votua komisioni për përpilimin e plasnit të punës së Kuvendit .

Antarët e komisionit janë :

Zarko Dejanovic-Kryesuesi

Hidajet Ahmeti-Zëvendës Kryesues

Milena Marinkovic-Drejtoresh e Administratës

Naser Shabani-Delegat

Dragisa Kojic-Zyrtar për buxhet

Kryesuesi e lecoj pikën e tretë të reëdit të ditës

3. Propozim –Vëendim për reralizimin e procedurës ligjore dhe miratimin e vendimit të Kuvendit – Komunal për emrimin e zëvendskryetarit për komunitete .

Kryetari I komunës u paraqit për fjalë dhe tha se të gjithë e dini se nënkryetari për komunitete deri tani nuk është zgjedhur , kishim emëra të ndryshëm , unë para dy muajve e kam propozuar znj.Selvije Rexhepi pork am qen I sëmure dhe nuk kam qen present , pastaj më kanë dhënë rekomandim me katër nënshkrime që të propozoj të njejtën për nënkryetare për komunitete dhe në bazë të shkresës nga ministrija tani e propozoj zonjën **Selvije Rexhepi** për nënkryetare për komunitete .

Kryesuesi jut ha delegatëve se propozimi për nenkryetar për komunitete z. Selvije Rexhepi dhe pyeti – a ka dikush nga delegatët për të thënë diqka , pasi askush nuk u parasqit e dha në votim .

Kryesuesi e konstatoi se është zgjedhur nënkryetarja për komunitete zonja Selvije Rexhepi me 14 vota PËR , 1 kundër .

Kryesuesi e uroj për zgjedhjen në funagsion .

Zonja Selvije Rexhepi e mori fjalën , I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe I falënderoj posaqërisht komunitetin Shqiptar si dhe delegatët tjerë të cilët kanë votuar për tu zgjedhur , gjithashtu ajo I tha qytetarëve të pranishëm se nuk do ti zhgënjej nga ana e sajë dhe tëë gjithë ata që do të kërkojn ndihmën e sajë do të jetë për të gjithë aty sepse Klllokoti është I të gjith neve .

Kryesuesi shtoj se është I lumtur që kemi zgjidhur këtë problem dhe se kjo ishte faji I delegatëve të komunitetit Shqiptar të cilët nuk mundeshin të pajtoheshin , dhe se kjo nuk ka ndodhur për shkak të udheheqsisë egzekutive, kryetarit , nenkryetarit ...

Pastaj u kalua në pikën të ndryshme .

4.të ndryshme ;

z.Naser e mori fjalën dhe fillimisht I përshëndeti të gjithë të pranishmit , tha se ndëgjoj fjalë për puntorët e komunës se dikush po ka të drejtë e dikush jo dhe kërkoj që ata puntorë të deklarohen me shkrim cilët janë të diskriminuar dhe nga cila parti . Do ta falenderoj kryetarin e komunës dhe të gjithë bashkpuntorëve që sot e kemi zgjedhur qështjen e nënkryetarit për komunitete , të gjithë e dijm që Selvija nuk do të na zhgënjej , e përshendes dhe I uroj pqër pozitën .

z.Hidajet përshëndetti dhe I uroj z.Selvije pa marrë parsysh që ajo nuk e ka marrë votën time mendoj se do të punoj me përgjithsi dhe do ta ketë mbështetjen time pakufi dhe në këtë formë do të jetë I garntuar trekëndëshi që e kerkon kushtetuta ligjore , nënkryetari për komunitete , zyra për komunitete dhe kuvendi .

unë në fillim e dhash një propozim për diskutim por aji nuk erdhi në miratim , nuk hyri në rend dite kërkoj nga kryesuesi që të diskutojm për atë temë .

z. Sasa Mirkovic I uroj zonjës Selvije për zgjedhjen e saj , I dëshiroj shumë sukses dhe shtoj se është I sigurt se do të kemi një bashkpunim të shkelqyshëm , sepse Ju edhe ne njifemi prej kohësh kur kam qenë nënkryetar I komunës së V it is gjithnjë kam thënë se keni qen një drejtor I jashtz\akonshtëm dhe do të jesh për të gjith neve një bashkpuntore e shkëlqyer. Më vjen mirë që keni maarrë një numër të votave dhe e shof se ju kanë votuar edhe delegatët nga Srpska janë zgjuar edhe pse është Dimri , më e rëndësishme që jemi të bashkuar dhe unik ky është një qëllim I të gjith neve .

Po kthehem në qështjen nuk e kam mbaruar replikën deri në fund , atë që e ceku Hidajeti se bëhet fjalë për diskriminim tek disa zyrtarë në komunë, kjo është një akuzë e rëndë sepse kur flisni për ato gjera duhet të jeni të kujdshëm . Po ju themë sepse jemi nga komunat për shembull dhe jo vetëm në Kosovë por në bashkësin ndërkombëtare , për multienin , bashkpunim të mirë ne sot këtu kemi edhe zyrtarë komunal të cilët nuk janë të thirrur të marrin pjesë në seancë të kuvendit , dhe nuk janë në vendin e tyre të punës . Secili zyrtar duhet të jetë në vendin e tij të punës . Unë si kryetar ,kjo që dua të them tani është se unë disa herë dhe panumer I kam liruar puntorët për ti kryer punët e tyre private dhe shumë

herë e e kam pyetur dhe ndodh nuk e kam pyetur kryetarin . Duhet të punohet është e keqe kur pala duhet të presë sepse zyrtari i cili duhet të lëshoj atë document nuk është aty .Kështu që me siguri të plotë vërtetoj se diskriminimi nuk egziston .

Kryetari ju drejtua Hidajetit dhe I tha se plotësisht pajtohet me të lidhur me diskriminimin por deri sa ishte aji drejtor I administratës . Në kohën kur Srecko Spasiq ishte kryetar komune , atë kohë në komunë ka mbretëruar terri dhe kaosi , sot komuna e Klllokotit shkon me përmirsim dhe hapa të shpejt nga përmirsimi . Ne vitin e kaluar kishim 14 projekte që ju nuk I kishit për 4 vite . Sa I përket diskriminimit në të cilat ju po thirrreni , unë po e pyes Perparimin kush e ka liruar atë tani që është në seancë ? Nëse dikush kërkon një document Aji nuk është në vendin e punës . Nëse shefi I prokurimit nuk e kryen një prokurim gjatë tër vitit për qka po flasim . Sa I përket se a ka diskriminim egzistojn organet e rendit të cilët janë për këtë qështje . Egzistojn puntorë të cilët në mandatin e kaluar kanë qëndryarë në shtëpi .Unë sillem njejt me të gjithë puntorët . Unë për prokurim paguaj person privat , punën e vlersoj unë ashtu siq duhet . Unë secilin e kam liruar kur kishte nevoja personale , ne komunë punojn njëzet e pesë për qind shqiptar , ndaj të gjithë puntorëve sillem njejt . Le të thot Perparimi nëse nuk e kam lejuar kur kishte nevoja të tij e kam liruar gjithnjë le të thot këtu , kur është dashtur të shkoj me zonjën në Shkup dhe nevoja të tjera .

z.Shqiprim tha se ju po flisni vetëm për Perparimin dhe nuk po I shifni drejtorët e tuaj , Kryesuesi ju përgjigj se drejtorët janë persona të emruarë .

Pasi që kryesuesi ju drejtua : z.Hidajet ju e keni zyrën tek unë dhe mund të vini për të punuar kur të dshironi .Janë tri ulse njëra për juve , e keni edhe kompjuterin . Por nuk doni të vini në punë , nuk është e sakt ajo që ju po thoni .

Zonja Rexhepi I përshëndeti të pranishmit dhe tha se kryetari po thot se Perparimi por nuk është aji I vetmi në komunë këtu dhe aji nuk është I kënaqur me notën , dhe të gjithë shërbyesit civil nuk janë të kënaqur me notën .Sipas kryetari do të thotë se askush asgjë nuk ka punuar nga komuniteti Shqiptar . Unë po flas në emër të tyre sepse unë e përfaqsoj komunitetin shqiptar . Kryetari tha se nga 50 puntorë janë ankuar 3 dhe komisioni I ka përmirësuar notën .

Pastaj kryesuesi ja dha fjalën z. Shqiprim I cili tha se ka një lutje për të dy kryetarët , a egziston mundësia që ne delegatët ti kemi emrat e të gjithë puntorëve për secilin se qfar norash kanë marë . Kryesuesi shtoi se mund të shkojnë në zyrën e administratës të kërkojnë dhe se do të ja japin per ti parë gjithcka që të intereson . Mund të barten edhe në Kuvend këto informata .

z. Hidajet u ndërlidh me këtë diskutim sa I përket komunitetit Shqiptar , e kemi një raport nga organizata joqeveritare , të cilin e kanë bërë në detaje për diskriminim I cili bëhet ndaj puntorëve shqiptar ndër këto ndërlidhet edhe notimi I puntorëve . Lirije Zeqiri Halabaku ajo është magjistër punon qe Nënt vite në komunën e Klllokotit dhe është notuar me dysh , Perparim Rexhepi aji veq se punon katër vite dhe është notuar me notë të dobët , Skender Hoda ka përvoj dymbëdhjet vjeqare dhe është notuar me dysh , a është kjky një notim real . Të gjith puntorët e komunitetit Shqiptar janë profesionist , dhe shtoj se I interesojn vetëm puntorët e komunitetit Shqiptar .

kryesuesi ja dha fjalën Sasa irkovic I cili ju drejtua Hidajetit dhe tha se do të ju kishte kuptuar sikur most ë kishit qen në qeverisje si drejtor I administratës dhe most ë kishit bërë diskriminim edhe ndaj shqiptarëve edhe ndaj serbëve ju edhe Srecko Spasic .

Keni vendosur zyrtar për të nënshkruar vendime të cilat I ka pru Srecko Spasiq për ndrrimin e vendeve të punës , pastaj nuk I keni siguruar kompjuterët për zyrtarë mjeti kryesor për shërbim në zyre. Ju e dini shumë mirë për kënd bëhet fjalë , kishte problem Aleksandar Periq , grua ja ime të cilën 4 vite e kenni largu nga puna e edhe nga zyra e saj , politikisht e keni shqetsuar edhe ju edhe Srecko Spasic . Dosta Vesic ishte e sulmuar fizikisht të gjitha I keni bërë , dhe jut ë flisni para këtij populli se ju e keni bërë punën me nder .

Ju edhe Srecko Spasiq duhet të turpërohi për punën tuaj që e keni bërë në atë periudhë dhe përfundoj bisedën .

z.Hidajet e ceku dhe tha se kryetari nuk duhet të mirret me të kaluarën , sepse për shkak të t ëish kryetarit Sasa Mirkovic tre puntor nuk punojn rrijn në shtepi , dy shqiptar dhe një serb , dhe kjo ka ndodhur në kohën e mandatit të tij .

Fjala ju dha drejtoreshës së bujqsisë znj. Doruntina Rexhepi e cila ju drejtua Hidajetit dhe I tha se edhe aji ishte drejtor si ajo tani dhe të gjithë e dijm se si është komuna multietnike . Sa I përket deklaratës së fundit po ju drejtohem juve , sepse këtu punojn disa persona që ishin pranë ish kryetarit dhe deshirojn të bejn ndonje kaos këtu ndërsa ne të gjithë e dijm si qëndrojn punët këtu . Për pakënaqsit e tyre personale që nuk kan mundur të shkojn tutje .

jalëen e mori drejtori I katastroit Dejan Vlajkovic , I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe tha se është I efasuar edhe pse e vlersoj jashtzakonisht z.Hidajet por shumë njerz e dijn se para juve qëndron njeriu ë cilit I ka bërë diskriminimin më të madhë e ka pasur nga ana e Hidajetit.Ju tani ketu keni të ftoht apo? Unë ne -15 c kam qëndruar 8 orë në zyre dhe z.Hidajet si udhëheqës I imi më ka marrur kompjuterin më a marrur skenerin dhe komplet dokumentacionin . Këto që tani I bënë shërbimi I zyrës së kuvendit , Dejan Vlajkovic I ka bërë vetëm edhe pse nuk kam qenë Jurist.

ri vite I notuar me notë Njish , Dy vite z.Hidajeti më ka notuar me Njish . Kur e kam pyetur pse ? kuvendi po punon me përgaditje , më ka thënë se këtë nuk e ke nga nga unë . Për tri vite asnjëher nuk am thënë se jamë I diskriminuar nga Hidajeti .

të fund Kryesuesi e mbylli seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal Klloot-Vërbovc në vitin 2019

Data: **31.01.2019**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Klokot –Vërbovc

